



**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE  
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL**

**Lloji i diplomës “ Mjekësi Veterinare ”  
niveli minimal i diplomës “Bachelor ”**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar , si dhe të Kreut II, IV dhe VII të VKM nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave , “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” të ndryshuar, Bashkia Delvinë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

☒ 1 (një) Specialiste Veteriner – kategoria e pages IV ;

**Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!**

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe PRANIMIN NE SHERBIMIN CIVIL  
NE KATEGORINE EKZEKUTIVE ) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për  
LËVIZJE PARALELE:**

**17 Qershor 2026**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për  
PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL:**

**22 Qershor 2026**

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:**

- 1-Veterineri i kryen të gjitha funksionet që i ngarkohen nga ligji dhe aktet nënligjore duke marrë parasysh specifikat e zhvillimit në bashki dhe njësi.
- 2-Jep përgjigje ligjore dhe teknike për problemet specifike që mbulon sipas detyrave që i ngarkohen.
- 3-Bashkëpunon me Drejtorinë e Shëndetit Publik , inspektoriatet sanitare dhe Agjensin kombëtare të ushqimit, në drejtim dhe parandalim të epidemive dhe sëmundjeve të kafshëve.

## **1 LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon IV;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Te zoteroje diplome te nivelit “Bachelor “ në Degën Mjeksi Veterinare .

### **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë pranë Bashkisë Delvine , dokumentat si më poshtë:

- a-Jetëshkrim i plotësuar;
  - b-Fotokopje të diplomës dhe liste notash e noterizuar.Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit ;
  - c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) në qoftëse ka;
  - d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
  - e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
  - f-Vetedeklarimin e gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
  - g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
  - h-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

***Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 17.06.2026.***

Bashkia Delvine  
Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Lagjia "Sinan Ballaci "

Rruga "Nazif Haderi "

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Në datën **19-06-2026**, Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Bashkisë Delvine , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele, si dhe datën ,vendin dhe oren e sakte ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine , nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

---

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohurite mbi Ligjin nr. 139, dt.17.12.2016 "Për vetqeverisjes vendore" i ndryshuar.
- Njohurite mbi Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar .
- Njohurite mbi Ligjin nr. 9131, dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike" i ndryshuar.
- Njohurite mbi Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare".
- Ligji nr.10 465, Datë 29.9.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
- VKM nr.230, datë 20.03.2013 "Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore".

### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

Kandidatet do të vlerësohen për pervojën ,trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën , si dhe çertifikimet pozitive .Totali i pikeve për këtë vlerësim është 40 pike.

**Kandidatet gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me :**

- a- Njohurite , aftësitë , kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës ;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme ;
- c- Motivimin , aspiratat dhe pritshmerinë e tyre për karrierën .

Totali i pikeve për këtë vlerësim është 60 pike.

### **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të

Bashkisë [www.bashkiadelvine.gov.al](http://www.bashkiadelvine.gov.al)

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljene fituesit.

## 2 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, informacion që do ta merni në faqen zyrtare “Shërbimit Kombëtar të Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Bashkisë Delvinë duke filluar nga data 19.06.2026.

### 2.1

#### KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar .

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë :

- a) Te jete shtetas shqiptare;
- b) Te kete zotësi për te vepruar ;
- c) Te zoteroje gjuhen shqipe , te shkruar dhe te folur ;
- d) Te jete në kushte shëndetsore që lejojnë të kyeje detyrën përkatëse;
- e) Te mos jete i denuar me vendim të formës së prere për të kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- f) Ndaj tij të mos jete marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil , që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nepunësin civil “ i ndryshuar .

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

- a) Te zoteroje diplome të nivelit “ **Bachelor** ” në Degën Mjeksi Veterinare.

### 2.2

#### DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin;
- b-Fotokopje të diplomës dhe liste notash e noterizuar.Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit ;
- c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d-Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

f-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet në Bashkinë Delvine .

**Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 22-06-2026 në adresën**

**Bashkia Delvine**

**Lagjia "Sinan Ballaci "**

**Rruga "Nazif Haderi"**

### **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **02.07.2026**, Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Bashkisë Delvine , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele, si dhe datën ,vendin dhe orën e sakte ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine , nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

### **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

-Njohuritë mbi Ligjin nr. 139, dt.17.12.2016 "Për vetqeverisjes vendore" i ndryshuar.

-Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar .

-Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike" i ndryshuar.

-Njohuritë mbi Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare".

- Ligji nr.10 465, Datë 29.9.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

-VKM nr.230, datë 20.03.2013 "Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore".

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

### **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

a- deri në 60 pikë për vlerësimin me shkrim;

b- Intervisten e strukturuar me gojë që konstiton në motivimin , aspiratat dhe pritshmerine e

- tyre per karrieren , deri ne 25 pike.
- c- Jeteshkrimin , qe konstiton ne vleresimin e arsimimit te pervojës e te trajnimeve , te lidhura me fushen, deri ne 15 pike.

## **2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Delvine do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen zyrtare të Bashkisë Delvine [www.bashkiadelvine.gov.al](http://www.bashkiadelvine.gov.al) si dhe në stenden e Bashkisë Delvine . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen zyrtare të Bashkisë Delvine [www.bashkiadelvine.gov.al](http://www.bashkiadelvine.gov.al) si dhe në stendat e Bashkisë Delvine :

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin e “Shërbimit Kombëtar të Punësimit” duke filluar nga data **02.07.2026**.